



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0474

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, duke vendosur sipas ankesës së OE “Jaguar Security” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objektit të Msh-se Depos se Barnave dhe Objektit të Marrur me Qira për Tri Inspektoratet dhe DSHB ne Lagjen Lakërishtë” me numër të prokurimit:206-25-1648-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Ministria e Shëndetësisë më 24/07/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e OE “Jaguar Security” SH.P.K. me nr. 2025/0474, e datës 09/06/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi Fizik i Objektit të Msh-se Depos se Barnave dhe Objektit të Marrur me Qira për Tri Inspektoratet dhe DSHB ne Lagjen Lakërishtë, me numër të prokurimit: 206-25-1648-2-1-1, (AK) - Ministria e Shëndetësisë.

2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Ministria e Shëndetësisë., ndërkaq aktiviteti i prokurimit sipas dispozitivit I të këtij vendimi, ndërkaq lënda kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërishtë e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.03.2025 Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objektit të Msh-se Depos se Barnave dhe Objektit të Marrur me Qira për Tri Inspektoratet dhe DSHB në Lagjen Lakërishtë” me numër të prokurimit: 206-25-1648-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës sherbime.

Me 29.05.2025 OE “Jaguar Security” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.06.2025 Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.06.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Jaguar Security” SH.P.K., me nr. 0474/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objektit të Msh-se Depos se Barnave dhe Objektit të Marrur me Qira për Tri Inspektoratet dhe DSHB në Lagjen Lakërishtë” me numër të prokurimit: 206-25-1648-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Jaguar Security” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Të pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 28.05.2025 për rekomandimin për dhënie të kontratës, si dhe vlerësimit të gabuar të ofertave të cilat nuk janë krahasuar dhe ekzaminuar sipas Nenit 59.4 të LPP-së sipas kërkesave të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë, konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar edhe në Nenin 64.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paraqesim këtë "ankesë" ndaj aktivitetit të prokurimit me titull: Sigurimi fizik i objektit të MSH-së, Depos së Barnave dhe Objektit të marrur me qira për tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërishtë me nr.prokurimi: 206-25-1648-2-1-1 e inicuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Për shkak se: Ministria e Shëndetësisë Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar operatorin ekonomik, i cili nuk ka plotësuar kërkesat dhe kriteret e aktivitetit të prokurimit me të dhënat e lartëcekura, duke mos e rekomanduar kompaninë tonë e cila ka qenë kompania më e lirë e përgjegjshme. Autortiteti Kontraktues ka ra në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik duke mos bërë vlerësimin e ofertave sipas kërkesave të vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të tenderit. Në bazë të gjendjes faktike, me rastin e vlerësimit të ofertave konform Nenit 59 të LPP së dhe Nenit 40 të Rregullores Nr.001/2022 të PP-së ne jemi diskriminuar gjatë vlerësimit, pasi që ofertat nuk janë trajtuar njejtë me vetë faktin se operatori ekonomik i rekomanduar me këtë rast është favorizuar dhe nuk mund të quhet trajtim i

barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së, por diskriminim total, dhe jo i drejtë.

Me datën 28.05.2025 Autoriteti Kontraktues në platformën e E-prokurimit fillimisht kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, të pakënaqur me këtë vendim në si operator ekonomik paraqesim kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues me datën 30.05.2025, duke dhënë pretendimet tona ankimore. Pas pranimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së, menjëher kemi kërkuar qasje në dokumentet publike të këtij aktiviteti të prokurimit, qasja nuk na është lejuar menjëherë por ditën e fundit dhe jo konform kërkesës sonë të parashtruar për këtë aktivitet të prokurimit pasi që Autoriteti Kontraktues, me çrast ka ra në kundërshtim me dispozitat ligjore Neni 7.6.3 të Rregullores Nr.002/2024 dhe Neni 11 par.4 të LPP-së.

Neni 7.6.3 i Rregullores Nr.002/2024 thotë: Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal për të dyja palët.

Pas pranimit të dëshmimeve të Grupit të OE-ve të cilët janë rekomanduar për kontratë konstatojmë se: Dokumenti me emërtim "Konzorciumi" e vendosur në ofertën elektronike, nuk është konform formularit standard të publikuar nga KRPP-ja tek platforma e Eprokurimit "MARRËVESHJE DEKLARATË për formimin e grupit 2024" e publikuar dhe hyrë në fuqi me datën 11.11.2024, poashtu edhe në dosjen e tenderit ju e keni bashkangjitur këtë dokument. Grupi i OE-ve ka ndërhyrë në dokument/formularin standard duke mos e përdorur dokumentin në fjalë.

Neni 44.3 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes "header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde.

Tek pjesa e përgjegjësive brenda deklaratës për themelimin e grupit ka përcaktuar 0% të përgjegjësisë për anëtarin MEB L.L.C e që është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe është e papranueshme.

Neni 26.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet të: a) Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;

Neni 26.15 i Rregullores Nr.002/2024 për Prokurimin Publik thotë: Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do të përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet të kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP. Poashtu dokumenti i themelimit të Grupit nuk është në fund i nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar, ky dokument nuk e posedon pjesën me të dhënat si: Përfaqësuesi i Autorizuar, Emri i kompanisë, vula dhe nënshkrimi, ky dokument ka të nënshkruar dhe vulosur

me të dhënat e dy kompanive pjesëmarrëse, mirëpo mungon edhe pjesa e fundit ku duhet të nënshkruhet Personi i Autorizuar (përfaqësuesi) sipas formularit standard e cila në fund ka pjesën e tretë që duhet të plotësohet.

OE anëtar i grupit të rekomanduar për kontratë "MEB" L.L.C ka dorëzuar vërtetimin e ATK-së me numër serik: 1001254096 të datës 20.05.2025 ku ceket se "...Aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura". Sipas dokumenteve që posedojmë ky Operator ekonomik ka Marrëveshje me ATK-në për të shlyer obligimet tatimore me këste e cila është lidhur mes dy palëve "ATK" dhe "MEB" me datën 01.04.2025.

Provë: Marrëveshja e lidhur mes ATK dhe MEB, datë 01.04.2025.

Sipas Interpretimit të KRPP-së të datës 22.12.2022 me numër rendor 6 të publikuar në platformën e E-prokurimit kemi këtë pyetje dhe përgjigje: A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë nëpagimin e tatimeve ndaj ATK së?

Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohën e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Neni 25.2 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: Kërkesat e pranueshmërisë, gjithnjë duhet të përmbushen nga OE. Pra rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontratë ashtu siç e kemi cekur është i përgjegjshëm, sepse nuk është i pranueshëm (i lejuar) ashtu edhe sipas interpretimit të KRPP-së, pasi që marrëveshjen me ATK-në për shlyerjen e borxheve e ka pas datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Neni 40.2 i Rregullores Nr.001/2022 të PP-së thotë: Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.

Neni 40.13 i Rregullores Nr.001/2022 të PP-së thotë: AK do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit Citoj dispozitën Neni 40.2.Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriterë ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Dispozitat e mëposhtme të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thojnë:

17.31 Ofertat nga ofertuesit të cilët nuk kanë marrë parasysh obligimet e dispozitave të mbrojtjes së punëtorëve dhe kushteve të punës të identifikuar nga autoriteti kontraktues në dokumentet e kontratës nuk mund të konsiderohen si në përputhje me dokumentet e kontratës. Për më tepër, kur ofertuesit nuk marrin parasysh në mënyrë të mjaftueshme këto detyrime në tenderët e tyre, tenderët e tyre mund të konsiderohen si jo-normalisht të ulët dhe mund të refuzohen për këtë arsye.

17.32 Në rast se çmimi i ofruar nga Ofertuesi nuk mbulon pagat minimale të punonjësve që do të përfshihen në ekzekutimin e kontratës, e rregulluar nga Ministritë në sektorë të ndryshëm, oferta mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët. Gjatë përcaktimit të pagave minimale dhe pagave që do tu paguhen të punësuarve, Autoritetet Kontraktuese dhe Ofertuesit duhet të respektojnë pagat minimale të kërkuara dhe taksat dhe kontributet sociale përkatëse të publikuara në sektorët përkatës. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë informacion lidhur me pagat minimale përkatëse të zbatueshme nga ana e Operatorit ekonomik gjatë vlerësimit të arsyetimeve të dorëzuara nga Operatorët ekonomik.

Kompania jonë ka bashkangjitur analizën financiare poashtu në Analizën financiare ka bashkangjitur mënyrën e llogaritjes në bazë të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 duke përfshirë shtesat të cilat i takojnë sipas Nenit 32 dhe 56 të po këtij ligji, pra kërkesa juaj është përmbushur me dëshmi nga ana e kompanisë sonë ashtu siç është kërkuar mirëpo jo edhe nga Operatori i rekomanduar për kontratë dhe operatorët tjerë ekonomik të cilët rradhiten më pas si: BESA SECURITY dhe DEFENCE SECURITY, pasi që me çmimin e ofertuar nuk mund të rrespektohen kërkesat në bazë të ligjeve të lartëcekura.

E vetmja kompania jonë ka aplikuar në bazë të ligjeve në fuqi duke rrespektuar shtesat tjera të cilat duhet ti gëzojnë punëtorët e sigurimit fizik që do të kryejnë këto shërbime. Në Aneks 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme keni cekur: Çdo ofertë që nuk e mbulon prapin e shpenzimeve të pagave të punëtorëve do të shpallet e papërgjegjshme.

Poashtu Autoriteti Kontraktues në vendimin e saj si përgjigje e kërkesës për rishqyrtim ka tentuar të na vë në lajthim në përgjigjen e dhënë në faqen nr.6/7 kundrejt Interpretimit të cilin e gjeni me numër rendor nr.06 (<https://e-prokurimi.rksgov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=544>) se është shfuqizuar ky Interpretim sipas versionit të konsoliduar të Rregullores në fuqi! Favorizimi i operatorit ekonomik i cili është shpërblyer me kontratë dhe mbrojtja që ju po ua bëni në njëerën anë, shkakton dëme kompanisë sonë në anën tjetër ku na bëhet padrejtësi, mirëpo për këtë janë rrugët ligjore që do të ndiqen padysim nga ana jonë. Bashkangjitur gjeni Rregulloren e re finale e cila është në fuqi e ku në faqen e fundit apo Neni 102 - Dispozitat e shfuqizimit, në asnjë paragraf nuk tregon shfuqizimin e Interpretimit nr.06. Shfuqizimi është bërë për Interpretimet me numër 07,08,12,28,29,31 dhe 33, dhe jo ajo numër 06 ku ne jemi thirrur në kërkesën për rishqyrtim.

Me çrast Autoriteti Kontraktues duhet të veproj në bazë të kërkesave të saja pasi që me mos veprim të vlerësimit të këtyre kushteve të përcaktuara përmes pyetje dhe përgjigjeve gjatë fazës para ofertimit ka dhënë shpjegime të cilat ne si ofertues i kemi zbatuar andaj mos aplikimi i tyre në fazë të vlerësimit cilësohet si trajtim jo i barabartë dhe diskriminim i neve kompanive që kemi zbatuar këto kërkesa.

Sipas Nenit 1 të LPP-së, Qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe

të gjitha fondeve duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Nga po e njejta dispozitë ligjore thuhet se ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Andaj konsiderojmë se një kërkesë e till e pacekur është në kundërshtim me Nenin 7.2 të LPP-së ku thuhet: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik".

Neni 7.4 i LPP-së thotë: "Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik". Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues ti trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veprojnë në mënyrë transparente, duke larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjor të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20/06/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0474/2025, ndërsa me datë 30/06/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0474 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Jaguar Security” SH.P.K., eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2025/0474 ka vlerësuar si në vijim:

Lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi Fizik i Objektit të Msh-së Depos së Barnave dhe Objektit të Marrur me Qira për Tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërisht”**, me nr. të prokurimit: **“206-25-1648-2-1-1”**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim, kriteri çmimi më i ulëti përgjegjshme.

Pas vlerësimit të ofertave, AK ka publikuar njoftimin B58, përmes të cilit rekomandon për dhënie të kontratës Grupin e Operatorëve Ekonomikë “KSF MAJOR” SH.A. dhe “MEB” L.L.C., me adresë në Tirana 5, 20000, Prizren, Kosovë.

OE ankues “JAGUAR SECURITY” SH.P.K. ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim me date 29.05.2025 në AK.

Autoriteti kontraktues AK-MSH, me date 04.06.2025, shqyrton kërkesën për rishqyrtim të OE ankues dhe refuzon.

Operatori Ekonomik ankues “JAGUAR SECURITY” SH.P.K., më datë 29.05.2025, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

AK – Ministria e Shëndetësisë, më datë 04.06.2025, ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga OE ankues dhe ka marrë vendim për refuzimin e saj.

I njëjti OE ankues parashtron ankesë pranë OSHP-së me pretendime se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka shkelur 1.Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092. Neni 1 - Qëllimi, Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi, Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës, Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste, Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve, Neni 60 - Kriteret për dhënie të kontratës. 2.Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik: Neni 27 - Kriteret e dhënies së kontratës, Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. 3.Ligji i Punës Nr.03/L-212.

Pretendimi ankimor nr.1

Eksperti shqyrtues sqaron se AK – Ministria e Shëndetësisë, për këtë procedurë të prokurimit në Kërkesat e përshtatshmërisë: ku është kërkuar: Kërkesat e përshtatshmërisë:

Dëshmia:

“2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”.

Eksperti shqyrtues këtë pretendim ankimor e vlerëson si të pabazuar, për arsye se Grupi i Operatorëve Ekonomikë “KSF MAJOR” SH.A.; ka dorëzuar vërtetimet e ATK-së para datës së njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me datë 04.03.2025, që nuk ka borxhe aktuale

ne ATK. Ndërsa anëtar i konsorciumit “MEB” L.L.C., sh.p.k. ka dorëzuar vërtetimin e ATK-së me datë 20.05.2025, në të cilin vërtetohet se ka lidhur marrëveshje për shlyerjen e borxhit në këste me ATK-në.

Pretendimi ankimor nr. 2

Operai ekonomik ankues pretendon se Grupi i Operatorëve Ekonomikë: “KSF MAJOR” SH.A.; “MEB” L.L.C., *“Pas pranimit të dëshmitë të Grupit të OE-ve të cilët janë rekomanduar për kontratë konstatojmë se: Dokumenti me emërtim "Konzorciumi" e vendosur në ofertën elektronike, nuk është konform formularit standard të publikuar nga KRPP-ja tek platforma e Eprokurimit "MARRËVESHJE DEKLARATË për formimin e grupit 2024" e publikuar dhe hyrë në fuqi me datën 11.11.2024, poashtu edhe në dosjen e tenderit ju e keni bashkangjitur këtë dokument”.*

Ekserti shlyrtues sqaron dhe vlereson këte pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se Grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar deklaratat individuale të secilit operator ekonomik si dhe deklaratën e përbashkët për themelimin e grupit, të cilat janë të nënshkruara dhe të vulosura konform kërkesave.

Prova: Në sistemin e E-Prokurimit janë të qasshme deklaratat individuale, deklarata e përbashkët për themelimin e grupit, si dhe përshkrimi i çmimit, i cili dëshmon ekzistencën e konzorciumit të Operatorëve Ekonomikë.

Pretendimi ankimor nr. 3

Operatori ekonomik ankues ne pretendon se: *“Kompania jonë ka bashkangjitur analizën financiare poashtu në Analizën financiare ka bashkangjitur mënyrën e llogaritjes në bazë të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 duke përfshirë shtesat të cilat i takojnë sipas Nenit 32 dhe 56 të po këtij ligji, pra kërkesa juaj është përmbushur me dëshmi nga ana e kompanisë sonë ashtu siç është kërkuar mirëpo jo edhe nga Operatori i rekomanduar për kontratë dhe operatorët tjerë ekonomik të cilët rradhiten më pas si: BESA SECURITY dhe DEFENCE SECURITY, pasi që me çmimin e ofertuar nuk mund të rrespektohen kërkesat në bazë të ligjeve të lartëcekura”.*

Ekserti shlyrtues sqaron dhe vlereson edhe këte pretendim ankimor si të pabazuar me arsyetimin se AK ne dosje të tenderit ka përcaktuar ne Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale, tek kërkesa 2:

“Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të respektoj Ligjin e Punës Nr.03 L-212 si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02-218 ku ceket se paga minimale është 350 euro bruto në muaj për punë me orar të plotë.

AK-MSh duke marrë ne konsiderate vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02 218 si dhe shtesat e parapara sipas Ligjin e Punës Nr.03 L-212, me qellim të mos dëmtimit të punëtorëve ne paga konsideron se Pragu minimal i pagës NETO për një punëtor ne total të jete min. $320+40 = 360$ euro për punëtor.

Dëshmia:

2. Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE se do të respektoj Ligjin e Punës Nr.03 L-212 si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02-218. Gjithashtu se ti realizoj pagën NETO për një punëtor ne total min. 360 euro për punëtor”.

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i Operatorëve Ekonomikë: “KSF MAJOR” SH.A. dhe “MEB” L.L.C. kanë dorëzuar deklaratën për pagën bazë dhe respektimin e Ligjit të Punës të datës 03.05.2025, të nënshkruar dhe vulosur, ku konfirmon dhe deklaron se gjatë implementimit të kontratës do të respektoj Ligjin e Punës Nr.03L-212, dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë.

Provë: Në e-prokurim gjeni deklaratën.

Mendimi i ekspertit shqyrtues është se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Veprimet e ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues janë të mbështetura në parimet e barazisë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, siç përcaktohet në nenin 6, 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit ka kryer vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave në përputhje me nenin 59 të LPP-së, përkatësisht në përputhje me procedurat ligjore dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

– Gjetjet e Panelit Shqyrtues–

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij Paneli Shqyrtues mori parasysh pjesërishtë Raportin e ekspertit shqyrtues mirpo nuk e mbështet rekomandimin që të mbete në fuqi vendimi i AK-se , dhe ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Jaguar Security” SH.P.K., të duhet të aprovohet si pjesërishtë e bazuar për faktin se lidhur me pretendimin ankimor lidhur me vertetimin tatimor të konzerciumit MEB L.L.C .Në DT për këtë aktivitet të prokurimit tek kërkesat e përshtatshmërisë është kërkuar citoj “ 2. *Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në*

tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”. Eksperti shqyrtues nuk e ka trajtuar në mënyrë të duhur pretendimin ankimor nga OE ankues duke mos marrë parasysh marrëveshjen e datës 01.04.2025, vetëm ka potencuar se “ MEB” L.L.C ka dorëzuar vërtetimin e ATK-së me numër serik: 1001254096 të datës 20.05.2025 ku ceket se “...Aktualisht është në marrëveshje me kështu për të shlyer borxhe tatimore të mbetura”. Sipas dokumenteve që posedojmë ky Operator ekonomik ka Marrëveshje me ATK-në për të shlyer obligimet tatimore me kështu e cila është lidhur mes dy palëve "ATK" dhe "MEB" me datën 01.04. 2025. Marrëveshja e lidhur mes ATK dhe MEB, datë 01.04.2025, mirpo vetëm e ka arsyetuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik “KSF MAJOR” SH.A.; ka dorëzuar vërtetimet e ATK-së para datës së njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me datë 04.03.2025, që nuk ka borxhe aktuale në ATK. Ndërsa anëtarë i konsorciumit “MEB” L.L.C., sh.p.k. ka dorëzuar vërtetimin e ATK-së me datë 20.05.2025, në të cilin vërtetohet se ka lidhur marrëveshje për shlyerjen e borxhit në kështu me ATK-në. Mirpo nuk i'u ka referuar interpretimit nga KRPP-ja ku thuhet “ OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast **marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës.** Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të paslyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë”. Paneli Shqyrtues përmes platformës elektronike e-prokurimi vëren se kjo procedurë është inicuar me datën 19.03.2025 15:53, ndërsa marrëveshja e konzorciumit i cili sipas Deklaratës mbi formimin e grupit ka ofrur 0 % pjesëmarrje . MEB L.L.C me Administratën Tatimore është pas publikimit të NJK dhe DT (Data e marrëveshjes me ATK-në me datën 01.04.2025).

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1, dhe 7 të LPP-së ka vendosur ta anuloj B58 Njoftim mbi vendimin e ATK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objektivit të Msh-se Depos se Barnave dhe Objektivit të Marrur me Qira për Tri Inspektoratet dhe DSHB në Lagjen Lakërishtë e me numër të prokurimit 206-25-1648-2-1-1”, ndërkaq lënda kthehet në Rivlersim.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II, III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - JAGUAR SECURITY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: